VENDIM
Nr. 667, datë 12.11.2025

PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR MIRATIMIN E SHTOJCËS SË MARRËVESHJES SHUMËPALËSHE TË AUTORITETIT KOMPETENT PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARISË FINANCIARE, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 178, DATË 9.3.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e deklaratës për miratimin e shtojcës së marrëveshjes shumëpalëshe të autoritetit kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare, miratuar me vendimin nr. 178, datë 9.3.2016, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCË E MARRËVESHJES SHUMËPALËSHE TË AUTORITETIT KOMPETENT PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARISË FINANCIARE

DEKLARATË

Unë, Petrit Malaj, ministër i Financave, në emër të Autoritetit Kompetent të Republikës së Shqipërisë, deklaroj se me anë të kësaj pranoj të pajtohem me dispozitat e:

Shtojcës së Marrëveshjes Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare

referuar në vijim si "Shtojca" dhe bashkëlidhur kësaj Deklarate.

Me anë të kësaj Deklarate, Autoriteti Kompetent i Republikës së Shqipërisë do të konsiderohet si nënshkrues i shtojcës që nga 6.10.2025. Shtojca do të bëhet efektive në lidhje me Autoritetin Kompetent të Republikës së Shqipërisë në përputhje me paragrafin 1 të seksionit 2 të saj.

Nënshkruar në Tiranë, më 6.10.2025.

PETRIT MALAJ

SHTOJCË E MARRËVESHJES SHUMËPALËSHE TË AUTORITETIT KOMPETENT PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARISË FINANCIARE

Duke pasur parasysh se Autoritetet Kompetente janë nënshkruese të Marrëveshjes Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare ("CRS MCAA");

Duke pasur parasysh se Autoritetet Kompetente synojnë të përmirësojnë vazhdimisht përputhshmërinë ndërkombëtare tatimore, duke ndërtuar më tej marrëdhënien e tyre, në lidhje me ndihmën e ndërsjellë në çështjet tatimore, siç pasqyrohet në shkëmbimet automatike ekzistuese të informacionit sipas CRS MCAA;

Duke pasur parasysh se CRS MCAA-ja parashikon që ligjet e juridiksioneve do të ndryshohen herë pas here për të reflektuar përditësimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit,

dhe sapo ndryshime të tilla në Standardin e Përbashkët të Raportimit të miratohen nga një juridiksion, CRS MCAA-ja do të konsiderohet se i referohet versionit të përditësuar, në lidhje me atë juridiksion;

Duke pasur parasysh se Standardi i Përbashkët i Raportimit është përditësuar në vitin 2023, për të ndryshuar fushëveprimin e tij dhe për të përmirësuar kërkesat e raportimit dhe procedurat e kujdesit të duhur;

Duke pasur parasysh se kjo shtojcë synon të shtojë disa informacione që do të shkëmbehen sipas CRS MCAA për të reflektuar kërkesat shtesë të raportimit, të paraqitura nga përditësimi i vitit 2023 në Standardin e Përbashkët të Raportimit;

Tashmë dhe si rrjedhojë, Autoritetet Kompetente kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

SEKSIONI 1
SHTESAT NË INFORMACIONIN QË DO TË SHKËMBEHET NË LIDHJE ME LLOGARITË E RAPORTUESHME

Sipas njoftimit në bazë të nënparagrafit 2(a)(i) të seksionit 2 të kësaj shtojce, informacioni shtesë që do të shkëmbehet në përputhje me nënparagrafin 2 të seksionit 2 të CRS MCAA- së, në lidhje me çdo llogari të raportueshme të një juridiksioni tjetër, është:

1. Nëse është dhënë një vetëcertifikim i vlefshëm për secilin mbajtës llogarie;

2. Roli/rolet në bazë të të cilit çdo person i raportueshëm që është person kontrollues i një subjekti mbajtës llogarie, është person kontrollues i subjektit dhe nëse është dhënë një vetëcertifikim i vlefshëm për secilin person të tillë të raportueshëm;

3. Lloji i llogarisë, nëse llogaria është një llogari që ka ekzistuar më parë apo një llogari e re dhe nëse llogaria është një llogari e përbashkët, duke përfshirë numrin e mbajtësve të llogarive të përbashkëta; dhe

4. Në rastin e ndonjë interesi në kapital të mbajtur në një subjekt investimi që është angazhim ligjor, roli/et, në bazë të të cilit të cilave personi i raportueshëm është mbajtës i interesit në kapital.

SEKSIONI 2
KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Kjo shtojcë do të jetë në fuqi në lidhje me autoritetet kompetente që janë, gjithashtu, nënshkruese të shtojcës. Ajo do të jetë pjesë integrale e CRS MCAA-së dhe dispozitat e CRS MCAA-së do të zbatohen *mutatis mutandis* në këtë shtojcë.

2. Një autoritet kompetent duhet t'i japë Sekretariatit të organit koordinues në kohën e nënshkrimit të kësaj shtojce ose sa më shpejt të jetë e mundur, pas kësaj:

a) Një njoftim të përditësuar në bazë të nënparagrafit 1(a) të Seksionit 7 të CRS MCAA-së:

i. që konfirmon se juridiksioni i tij ka ligjet e nevojshme në fuqi për zbatimin e përditësimit të vitit 2023 të Standardit të Përbashkët të Raportimit dhe që specifikon datat përkatëse të hyrjes në fuqi në lidhje me seksionin I të kësaj shtojce dhe zbatimin ose përfundimin e procedurave të përmirësuara të raportimit dhe kujdesit të duhur, ose çdo periudhë të zbatimit të përkohshëm të kësaj Shtojce për shkak të procedurave legjislative kombëtare në pritje (nëse ka); ose

ii. që tregon se juridiksioni i tij nuk ka ende ligjet e nevojshme në fuqi për zbatimin e përditësimit të vitit 2023 të Standardit të Përbashkët të Raportimit dhe, për këtë arsye, kërkon pëlqimin për të vazhduar dërgimin e informacionit pa zbatimin ose përfundimin e procedurave të përmirësuara të raportimit dhe kujdesit të duhur të përditësimit të vitit 2023, të Standardit të Përbashkët të Raportimit, gjatë një periudhe të caktuar tranzitore; dhe

b) Një njoftim të përditësuar në bazë të nënparagrafit 1(f) të seksionit 7 të CRS MCAA-së, që specifikon juridiksionet e autoriteteve kompetente, për të cilat pranon kërkesën e tyre të specifikuar në njoftimin e dhënë në bazë të nënparagrafit 2(a)(ii) të kësaj shtojce.

Përgatitur në gjuhët angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike.